



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i studimit me karakter profesional në “Operator  
dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”  
i  
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Etleva Refatllari
2. Prof. Vjollca Durro

Qershor/ 2022



## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit me karakter profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 487, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim i parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2020-2021)	8 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve: (2018-2021); Shënim: 2021-2022 asnjë student i regjistruar	23 Student
19	Komente / të tjera:	



## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Barleti (UBa) është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM 571, datë 12.8.2005 si Shkolla e lartë Universitare, Jo publike Universiteti "Marin Barleti" me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. Universiteti gjatë viteve e ka zgjeruar aktivitetin e tij me fakultete dhe programe të reja si dhe ka pësuar riorganizime. Me Urdherin nr. 309, datë 27.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe shkencës, "Riorganizim i Brendshëm i Njesive Kryesore te Shkolles se Larte Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti"", organizohet në katër fakultete: Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Shkencave të aplikuara. Me Urdhër 202, datë 25.05.2015 MARS dhe VKA nr 05.05.2015, Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti", organizohet me Fakulteti i Drejtësisë dhe shkencave Politike (5 njësi bazë) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë (4 njësi bazë).

Në vitin 2019 me Urdhërin nr. 511 datë 24.10.2019 të MARS "Universiteti Marin Barleti" Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Politike riorganizohen në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit" me katër njësi bazë. Në vitin 2020 me Urdhërin nr. 213 datë 03.07.2020 të MASR Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti "Barleti" (UBa) me tre Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë, Fakulteti i shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.


UBa është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 9 datë 7.04.2017 dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri më 15.12.2026.

UBa ofron programe studimi me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe certifikime për aftësimin e arsimit të vazhdueshme, programe të ciklit të parë, programe të ciklit të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve.

Programi i studimit me karakter profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore" zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit përbëhet nga katër departamente Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit dhe Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.

Programi i studimit me karakter profesional në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore" zhvillohet në Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, miratuar me Urdhër Nr.487, datë 27.07.2018 të MARS dhe ofrohet me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome profesionale në "Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore".





## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit profesional në “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”, i ofruar nga Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit me karakter profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 5 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Etleva Refatllari, Prof. Dr. Vjollca Durro. Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aviola Bardhi.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UBa e zhvilluar në datat 17 Mars 2022. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.




Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UBa.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 30/05/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/43 Prot., datë 03/06/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 10/06/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 743 Prot., datë 10.06.2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet ne raport final.





## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Universiteti “Barleti” (UBa) është institucion jopublikë i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 571, datë 12.8.2005 me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. Gjatë viteve UBa ka shtuar programe dhe fakultetet të reja dhe ka pësuar disa riorganizime.</p> <p>Në vitin 2019 me Urdhërin nr. 511 datë 24.10.2019 të MARS Për organizimin e dy njësive kryesore dhe hapjen e një njësie kryesore në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Politike riorganizohen në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit” me katër njësi bazë, ku bën pjesë dhe Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.</p> <p>Në vitin 2020 me Urdhërin nr. 213 datë 03.0.2020 të MASR Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti “Barleti” (UBa) me tre Fakultete si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë</li><li>- Fakulteti i shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative</li><li>- Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit</li></ul> <p>Programet që ofron UBa janë në përputhje me profilin e institucionit me qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte Europiane nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor për përgatitjen e individëve të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv [takimi me dekanin, evidenca nr2. Statusi i institucionit].</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Drejtimit prioritar akademike të institucionit janë përcaktuar në dokumentat themelore të tij si Statuti i UBa miratuar me Urdhër Nr. 360 , datë 23.12.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Rregullorja e UBa miratuar me Vendim Nr. 60, datë 13.04.2021 të Senatit Akademik Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve miratuar me Vendim Nr. 64/1, datë 13.04.2021 të Senatit Akademik si dhe Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit me nr. 111 Prot, datë 16.02.2021. [evidenca nr.3, evidenca nr.5% nr. 6].</p>



	<p>UBa ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njësive dhe strukturave të tjera si rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit, rregullore NJSBC, rregullore e sekretarisë, rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, etj. [evidencat 6,7,8,9,10,11,12,13.]</p> <p>Rregullorja e Departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit dhe Rregullorja e programit të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” (OKPSH) kanë mbivendosje të kompetencave dhe përgjegjësi</p> <p><b>GVJ rekomandon rishikimin e këtyre dy rregulloreve.</b></p> <p>UBa ofron programe studimi me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe çertifikime për aftësimin e arsimit të vazhdueshme, programe të ciklit të parë, programe të ciklit të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve. Programet e studimit të ofruara nga UBa synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive nëpërmjet ofrimit të programeve formuese dhe trainuese dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UBa për ti shërbyer zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë shiptare si dhe përparimit të arsimit të lartë dhe kërkimor shkencor në nivel kombëtar.</p> <p>UBa e ka fokusuar veprimtarinë e vet në disa drejtime si shkencat ekonomike; juridike; shkencat sociale, turizmit dhe sporteve; shkencave të aplikura dhe industrive kreative dhe në këtë kuadër në këto drejtime studimi janë edhe programet studimit. UBa synon zbatimin, ruatjen dhe konsolidimin e vlerave akademike si dhe zhvillim të qëndrueshëm dhe afat gjatë. Nëpërmjet ofrimit të programe universitare profesionale UBa ka si qëllim orientimin e studentëve në tregun e punës brënda dhe jashtë vendit. [statusi, dhe rregullorja e Uba, strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore, zhvillohet nga Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. FSHSTS përbëhet nga katër departamente Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional, Departamenti i edukimit fizik dhe sporteve, Departamenti i turizmit, mikritjes dhe rekreacionit, Departamenti i shkencave të sjelljes dhe shëndetit. Në FSHSTS sipas departamenteve zhvillohen 10 programe studimi is vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Master profesional në: Edukim me profil mësimdhënia e të nxënit.</li> </ul> </li> <li>- Departamenti i edukimit fizik dhe sporteve</li> </ul>



	<p>b) Program profesional në: Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike.</p> <p>c) Bachelor në Edukim fizik dhe Sporte.</p> <p>d) Master profesional në: Mësuesi dhe edukim fizik dhe sporte</p> <p>e) Master shkencor në: Mësuesi dhe edukim fizik dhe sporte</p> <p>-Departamenti i turizmit, mikritjes dhe rekreacionit</p> <p>a) Bachelor në :Menaxhim në turizëm, rekreacion dhe Evente</p> <p>-Departamenti i shkencave të sjelljes dhe Shëndetit.</p> <p>b) Program profesional në Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore</p> <p>c) Bachelor në psikologji</p> <p>d) Bachelor në Punë Sociale</p> <p>e) Mastër shkencor në: Psikologji shkollore dhe zhvillimi</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor në FSHSTS, si njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi realizohet nga pedagogë efektive (PAE) dhe pedagogë me kontratë (PAK) të cilët zotërojnë tituj akademik dhe grada shkencore.</p> <p>Profili i programit të studimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij përputhet me atë të njësisë kryesore. <i>[rregullorja e FSHSTS, rregullorja e programit të studimit, tabelat përmbledhëse].</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit e FSHSTS u theksua se për këtë program studimi <b>nuk ka studim tregur</b>, por informacionin mbi tregun e punës departamenti e ka siguruar nga bordi i karrierës, diskutimet me profesionistë nga fusha e shëndetësisë, sociologjisë dhe psikologjisë.</p> <p><i>[takimi me dekanin e fakultetit, RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin</p>	



real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UBa është një institucion që funksion në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brenda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës.</p> <p>Aktet ligjore rregullatore përcaktojnë organizimin, funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e stafit sipas pozicionit dhe funksioneve që kryejne në strukturat e universitetit, fakultetit apo programit të studimit ku ata janë të angazhuar.</p> <p>Disa prej anëtarëve të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose angazhuar në komisione “ad hoc” të ngritura për tematika të ndryshme. Në mënyre periodike njësia kryesore, njësitë bazë, programet e studimit dhe njësitë mbështetëse si NJSBC, sekretaritë mësimore, këshillimi i karrierës, kyejnë analizën e aktivitetit të tyre, nxjerrin përfundimet dhe përcaktojnë masat që duhen të meren në zgjidhjen e problematikave të ndryshme apo përmirësimet e nevojshme. Në komunikimin e brendshëm midis stafit të institucionit një rol të rëndësishëm luan sistemi i komunikimit elektronik nëpërmjet se cilit realizohet shkëmbimi dhe përditësimi i informacionit, ndarja e punës etj. Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. [takimi me dekanin, shefin e departamentit, stafin akademik, evidenca nr.38 Analiza vjetore e departamentit].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UBa është një institucion jo publik që ka një numër të vogël studentësh në këtë program studimi sepse ky është një program i ri (2018-2022), por jo në numër programesh që ofron [Rregullorja e UBa]. Në funksion të programit profesional të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon si dhe ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet publike dhe jo publike, OJF, institucione shëndetësore. Pranë këtij departamenti është ngritur dhe <b>Bordi i</b></p>



	<p><i>karrierës</i> me përfaqësues nga departamenti, institucione shëndetësore, OJ, Urdhëri psikologut.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani apo institucione të ndryshme u mundësojnë studentëve kryerjen e praktikës profesionale, intershipte të cilat ju shërbejnë për thellimin e njohurive dhe përfitim të aftësive dhe kompetencave profesionale si dhe vendosjen e kontakteve me biznesin për punësimin e tyre. [RVB, takimi me stafin drejtues, evidenca nr.34 marrëveshje të bashkëpunimit institucional].</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në mënyrë periodike departamenti ku zhvillohet ky program studimi harton raportin mbi realizimin e programit mësimor, opinionin e studentëve lidhur me logjistikën në funksion të programit, aktivitetet të kryera gjatë vitit akademik në funksion të programit të studimit. Të dhënat e raporteve i shërbejnë departamentit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Numri i studentëve në programin profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” ka qenë i pakët dhe konstatohet një rritje të numrit të studentëve. Për vitin akademik 2018-2019 janë rregjistruar tetë studentë, për vitin akademik 2019-2020 dymbëdhjetë studentë dhe vitin 2020-2021, katër studentë. [takimi me stafin drejtues, evidenca nr 27 të dhëna për rregjistrimin e studentëve]</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni ka të dhëna lidhur me institucionet ku studentët kryejnë praktikën profesionale bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni. Praktika mbikëqyrjet nga një pedagog i caktuar si dhe kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Realizimi i praktikës dhe vlerësimi kryhet sipas udhësuesi “Paketa e praktikës” dhe rregullores përkatëse të programit të studimit OKPSH. [dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik, evidenca nr 7. Rregullorja e programit të studimit].</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Njësi bazë ku realizohet ky program studimi në bashkëpunim me Bordin e karrierës dhe institucionet të tjera organizon aktivitete të ndryshme si vizita institucionale, aktivitete ekstrakurrikulare trajnime të ndryshme, seminare të cilat i shërbejnë përditësimit të kurikulës/syllabuseve si dhe ndihmon studentët për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës dhe marrjen e informacioneve për mundësi punësimi. [takimi me stafin drejtues, RVB, dokumenti Trajnime të mëtejshme profesionale për studentët e diplomuar, evidenca 38. Naliza vjetore e departamentit]</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X



<b>Standardi L3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit profesional “Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore”, është hapur në vitin 2018, me urdhër të MARS Nr.487, datë.27.07.2018. Programi i studimit ofrohet nga zhvillohet nga Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) në Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit dhe ky është akreditimi i parë që kryhet për këtë program studimi.</p> <p>Ky program studimi i referohet nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome profesionale në “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” referuar nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) [rregullorja e FSHSTS rregullorja programit].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi profesional në OKPSH synon dhënien e njohurive të konsolidura profesionale dhe aftësive praktike në fushën e përkujdesjes shëndetësore.</p> <p><i>Programi i studimit nuk i përmban të gjitha elementët e organizimit të prashikuar në VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë të ndryshuar”, miratuar me VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018, pasi ky program studimi është hapur në vitin 2018.</i></p> <p>Në takimi me drejtuesit e fakultetit, njësisë bazë dhe kordinatorit e programit të studimit u theksua se këto mangësi lidhen me mungesën në legjislacion për organizimin e programit të studimit me karakter profesional sepse VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” nuk parashikonte organizimin e programeve me karakter profesional.</p> <p>Riorganizimi i programit sipas VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar, do bëhet pas akreditimit.</p> <p>Programi i studimit profesional OKPSH përmban një informacion të plotë në fushën e përkujdesjes shëndetësore nëpërmjet ndërthurjes së informacione dhe njohurive të shkencave mjekësore me ato të shkencave sociale.</p>



	<p>Ky program formon studentë me kompetenca profesionale bazë për të ofruar këshillim dhe përkujdesje shëndetësore ndaj individëve në nëvojë në institucione apo komunitet.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës lidhur me ofrimin e këshillimit dhe përkujdesjes shëndetësore dhe do ju shërbejnë si bazë zgjerimin e njohurive të tyre profesionale në kualifikime të mëtejshme. <i>[programi studimit, plani mësimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit profesional i OKPSH ju siguron studentëve njohuri teorike dhe praktike për menaxhimin e probleme të ndryshme në fushën e përkujdesjes shëndetësore në grup moshë të ndryshme si fëmijët, moshë e tretë apo kujdes reabilitimi. Programi është me karakter profesional ku një rëndësi të vecantë zë aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve që UBa ka me institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe sociale. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për ofrimin e kujdesit shëndetësor në situata të veçanta që lidhen me nevojat e tregut të punës, lëndë specifike që lidhen me formin e tyre profesional dhe aftësive të komunikimit <i>[Plani mësimor]</i>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi i studimit profesional nëpërmjet ofrimit të njohurive teorike dhe praktike siguron/ofron formimin e studentëve me kompetenca profesionale bazë për të ofruar këshillim dhe përkujdesje shëndetësore ndaj individëve në nëvojë në institucione shëndetësore publike dhe jo publike, qendra të shërbime sociale apo komunitet.</p> <p>Programi i studimit synon që studenti të fitoj aftësi dhe kompetencë për të menaxhuar në mënyrë të pavarur situata të ndryshme të pacientëve, për tu përballur dhe zgjidhur problemetika të lidhura me ofrim këshillimi apo përkujdesje shëndetësore, për ti shërbyer pacientëve apo individëve në nevojë me etike dhe kujdesje profesionale, zgjidhjen e situatave komplekse dhe të paparashikuara me pacientin. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, ky program studimi i shërben kualifikimit të tyre profesional për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike spitalore apo institucione të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe asistencë sociale. <i>[rregullorja e programi, takimi me studentët]</i>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/ njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe</p>	<p>UBa është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë. Institucioni përbëhet nga njësiti kryesore, bazë, ndihmës akademike dhe administrative dhe</p>



<p>numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>organet këshilluese(bordet e ndryshme) të organizuara në pesë shtylla si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shtylla akademike</li> <li>- shtylla studentit</li> <li>- shtylla e kërkimit të aplikua dhe inovacionit</li> <li>- shtylla korporative dhe administrative</li> <li>- shtylla sipërmarrjes</li> </ul> <p><b>Shtylla akademike</b> përbëhet nga njësitë kryesore, njësitë bazë, organet kolegjiale dhe autoritet drejtuese. Organet kolegjiale drejtuese të UBa janë Senati akademik, rektorati, Këshilli etikës dhe shanceve të barabarta, Komisioni i sigurimit të cilësisë, Komisioni i vlerësimit të performancës dhe Asambleja e stafit akademik.</p> <p>Organet kolegjiale drejtuese të Fakultetit janë Dekanati dhe Asambleja e stafit akademik të fakultetit.</p> <p>Autoritet drejtuese të UBa janë rektori me zv rektorët dhe administratori. Autoritet akademike janë rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë dhe qëndrës kërkimore shkencore.</p> <p><b>Shtylla studentit:</b> autoriteti drejtues është zëvendës rektori për studentët dhe komunitetin. Njësitë përbërëse të saj janë :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i. Zyra e rekrutimit, pranimi dhe rregjistrimit,</li> <li>ii. Zyra e dekanit të studentëve</li> <li>iii. Zyra e alumnit dhe karriera</li> </ol> <p><b>Shtylla- Organizimi administrative dhe korporativë.</b> Organet administrative janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, administratori i deleguar, sekretari përgjithshëm, njësitë kryesore <b>[statusi i UBa)</b>.</p> <p><b>Shtylla e kërkimit të aplikua dhe inovacionit</b> përfshin departament ku zhvillohet aktiviteti kërkimor shkencor, qëndra dhe shoqata (OJF) me aktivitet kërkimor aplikativ dhe inovativ në mëbshetje të punës akademike dhe iniciativa të tjera brënda institucionit.</p> <p><b>Shtylla e sipërmarrjes</b> fokusohet në veprimtaritë e sipërmarrjeve të ngritura nga universiteti.</p> <p>UBa ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.9, datë 07.04.2017 dhe dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2026. Programet e studimit që ofron institucioni janë akredituar ose janë në proces akreditimi nga institucionet përgjegjëse.</p> <p>Programi i studimit profesional OKPSH zhvillohet në Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS) të hapur me urdhër të MARS nr. 202, datë 25.05.2015 si <i>Fakulteti i Drejtësisë</i></p>
--	---



*dhe Shkencave Sociale politike dhe riorganizohet në vitin 2019 Urdhërin nr. 511 datë 24.10.2019 të MARS në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit,*

Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit” përbëhet nga katër departamente: Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional, Departamenti i edukimit fizik dhe sporteve, Departamenti i turizmit, mikritjes dhe rekreacionit, Departamenti i shkencave të sjelljes dhe shëndetit ku zhvillohet ky program studimi. Në Departamentin e shkencave të sjelljes dhe Shëndetit zhvillohen katër programe studimi si vijon:

- a) Program profesional në Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore
- b) Bachelor në psikologji
- c) Bachelor në Punë Sociale
- d) Mastër shkencor në: Psikologji shkollore dhe zhvillimi

Për realizimin e programeve të studimit në njësinë kryesore dhe njësinë bazë janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë të kualifikuar që zotëorjnë tituj dhe grada shkencore.

Përbërja e stafit akademik në njësinë kryesore sipas viteve është si vijon :

**Për vitin akademik 2020-2021** janë angazhuar 40 (dyzetë) PAE dhe 26 (njëzet e gjashtë) PAK. Në stafin PAE 9 (nëntë) janë të kategorisë profesor 13 (trembëdhjetë) janë doktorë shkencash dhe 18 (tetëmbëdhjetë) janë Msc. Nga PAK 1 (një) është i kategorisë profesor, 13 (trembëdhjetë) janë doktorë shkencash, 12 (dymbëdhjetë) janë Msc.

**Për vitin akademik 2019-2020** janë angazhuar 34 (tridhjetë e katër) PAE dhe 37 (tridhjetë e shtatë) PAK. Në stafin PAE 7 (shtatë) janë të kategorisë profesor 9 (nëntë) janë doktorë shkencash dhe 18 (tetëmbëdhjetë) janë Msc. Nga PAK 2(dy) janë të i kategorisë profesor, 1 (njëmbëdhjetë) doktorë shkencash, 21(njëzetënjë) janë Msc. [Në tabelën 1 te Aneksi nurmi PAE është 33 dhe PAK 37]

**Për vitin akademik 2018-2019** janë angazhuar 40 (dyzetë) PAE dhe 26 (njëzet e gjashtë) PAK. Në stafin PAE 9 (nëntë) janë të kategorisë profesor 13 (trembëdhjetë) janë doktorë shkencash dhe 18(tetëmbëdhjetë) janë Msc. Nga PAK 1 (një) është I kategorisë profesor, 13 (trembëdhjetë) janë doktorë shkencash, 12 (dymbëdhjetë) janë Msc

Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e procesit mësimor **në njësinë bazë** (departamenti shkencave të sjelljes dhe shëndetit) sipas viteve është si vijon :

**Për vitin akademik 2020-2021**, janë angazhuar 7(shtatë) PAE dhe 11(njëmbëdhjetë) PAK. Nga PAE 1 (një) është kategoria profesor, 5 pesë doktorë shkencash , 1 një Msc. Nga PAK 6 (gjashtë) janë



doktorë shkencash, 5 (pesë) janë Msc. [Në tabelën 1 te Aneksi numri PAE është 6 dhe PAK 11. Në tabelën nr 2 PAE 8 dhe PAK 4]

**Për vitin akademik 2019-2020** janë angazhuar 7 (shtatëtë) PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) PAK. Nga PAE 3 (tre) janë të kategorisë profesor, 2 (dy) doktorë shkencash , 2 (dy) Msc. Nga PAK 1 (një) është i kategorisë profesor, 7 (shtatë) janë doktorë shkencash, 3 (tre) janë Msc. [Në tabelën 1 te Aneksi numri PAE është 12 dhe PAK 22. Në tabelën nr 2 PAE 9 dhe PAK 2].

**Për vitin akademik 2018-2019** janë angazhuar 7 (shtatë) PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) PAK. Nga PAE 1 (një) është i kategorisë profesor, 5 (pesë) doktorë shkencash , 1 (një) Msc. Nga PAK 6 (gjashtë) janë doktorë shkencash, 5 (pesë) janë Msc. [Në tabelën 1 te Aneksi numri PAE është 6 dhe PAK 11. Në tabelën nr 2 PAE 10 dhe PAK 7].

Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e procesit mësimor **në programin studimit profesional në OPKSH** sipas viteve është si vijon :

**Për vitin akademik 2020-2021**, janë angazhuar 8 (tetë) PAE dhe 4 (katër) PAK. Nga PAE 2 (dy) janë kategoria profesor, 1 (një) doktorë shkencash , 5 (pesë) Msc. Nga PAK 4 (katër) janë Msc.

**Për vitin akademik 2019-2020**, janë angazhuar 9 (nëntë) PAE dhe 2 (dy) PAK. Nga PAE 2 (dy) janë kategoria profesor, 1 (një) doktorë shkencash , 6 (gjashtë) Msc. Nga PAK 2 (dy) janë Msc.

**Për vitin akademik 2018-2019**, janë angazhuar 3 (tre) PAE dhe 4 (katër) PAK. Nga PAE 3 (tre) janë Msc. Nga PAK 4 (katër) janë Msc.

Në vite konstatojmë rritjen e numrit dhe cilësisë së stafit akademik të përfshirë në procesin e mësimdhënies në programin e studimit OPKSH.

**Për vitin akademik 2018-2019 PAE realizojnë 58% të ngarkesës mësimore dhe PAK realizojnë rreth 42% të ngarkesës mësimore.** Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020 -2021 PAE realizojne rreth 80% të ngarkesës mësimore dhe PAK realizojnë 20% të ngarkesës mësimore.

**Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GJV konstaton :**

-Mospërputhje të të dhënave për numrin e pedagogëve të përfshirë në procesin mësimor në FSHSTS dhe departamentin e shkencave të sjelljes dhe Shëndetit të paraqitur në tabelat nr. 1 dhe nr 2.

- Mospërputhje të të dhënave të stafit të angazhuar në mësimdhënie për realizimin e programit mësimor të pasqyruar në tabelën nr. 6 dhe tabelën nr 12 (Aneksi).



	<b>Bazuar në konstatimet e mësipërme GVJ rekomandon rishikimin e stafit të angazhuar në mësimdhënie për realizimin e programit mësimor.</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Kurikula dhe përmbajtja e Programit të studimit krijojnë mundësi studentit për formimin e tij profesional në fushën e ofrimit të përkujdesit shëndetësor. Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për formimin e tyre profesional dhe ofron njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore dhe sociale, për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencës profesionale të studentëve si këshillues dhe ofrues të përkujdesit shëndetësor për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës jo vetëm brënda vëndit po dhe jashtë tij. <i>[evidenca .. kurikula e programit]</i> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		



## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit profesional OKPSH ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike/karakterizuese për profilet të veçanta të kujdesit shëndetësor që lidhen me nevojat e tregu të punës, lëndë specifike që lidhen me shkencat sociale. Në programin e studimit, studenti gjen informacion të plotë me strukturën dhe organizimin e planit mësimor sipas viteve akademike, syllabuset, mënyrën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mënyrën e vlerësimit, kryerjen e praktikave mësimore, fushat e mundëshme të punësimit të tyre, informacione lidhur me tregun e punës [takimi me studentë, plani mësimor, programi mësimor, syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi studimit profesional OKPSH është i organizuar në lëndë karakterizuese, ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese por nuk përfshin lëndët bazë dhe detyrimet përmblyëse sipas VKM nr 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar”. Lëndët formuese realizohen në ETC dhe grupohen si më poshtë :</p> <p><b>A. Lëndë bazë: ska</b></p> <p>B. Lëndë karakterizuese: 60 ETC</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese: 24 ETC.</p> <p>D. Lëndë plotësuese: 36 ETC</p> <p><b>E. Detyrime përmblyës: ska</b></p> <p>Këto lëndë ofrohen nga petagogë me tituj dhe gradë shkencore në përputhje me ekspertizën që ofrojnë . [plani mësimor, takime me stafin drejtues dhe akademik].</p> <p><b>Në takimin me stafin drejtues u theksua se organizimi i programit nuk përputhet me VKM nr 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” sepse në të nuk pasqyrohen programet e studimit me karakter profesional. Riorganizimi i programit do të kryhet pas procesit të akreditimit.</b></p> <p><b>GVJ rekomandon riorganizimin e programit mësimor sipas VKM 185 datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve</b></p>



	<p><b>të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar</b></p> <p><i>[evidenca 7 Rregullorja e programit të studimit, dokumenti Plani mësimor i programit].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Lëndët e programit realizohen sipas planit mësimor por mungon orari i realizimit të programit mësimor javor. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të katërt semestrat janë organizuar në leksione (570 orë në auditor të ndara në 300 orë mësimore në vitin e parë dhe 300 orë në vitin e dytë), seminare (420 orë mësimore në auditor) të ndara 210 orë në vitin e parë dhe 210 orë në vitin e dytë, orë laboratorike (180 orë mësimore në auditor të ndara nga 90 orë mësimore në çdo vit akademik), praktikë profesionale (540 orë në auditor të ndar nga 270 orë në çdo vit akademik).</p> <p>Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 50% për leksionet, 75% për praktikën profesionale, seminare dhe laboratorët. Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta. Orët e praktikës realizohen nga 135 orë në çdo semestër. Praktika profesionale kryhet pranë institucioneve shëndetësore publike dhe jo publike si dhe qëndrave sociale me të cilat institucioni ka lidhur kontratë /marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të mara nga studenti bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit mësimor si vijon : provimi i ndërmjetëm 20%, pjesmarrja dhe aktivizimi 10%, detyra kursi 20% dhe provimi përfundimtarë 50%. <i>[evidenca nr 7. rregullorja e programit, evidenca nr.19 sylabuset, plani mësimor]</i></p> <p><b>NË dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstaton :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Mangësi në plotësimin e dokumentit të disa marrëveshjeve të bashkëpunimit si: mungojnë firma e të dy palëve përfaqësuese, data, nr protokollit.</b></li> <li>- <b>Mospërputhje të ngarkesës mësimore (orë mësimore) të pasqyrura në tabelën e planit mësimor me (1710 orë në auditor) me tabelën nr. 13 (1350 orë) dhe tabelat 12,1;12.2;12,3 respektivisht 1240 orë, 1260 orë dhe 1260 orë.</b></li> <li>- <b>Mospërputhje të orëve mësimore të praktikës profesionale të pasqyruar në tabelën e planit mësimor (135 orë për semestër, total 540 orë) me orët e pasqyruar në ngarkesën e pedagoqeve tabelat nr.12 dhe tabelën nr.13.</b></li> <li>- <b>Mungon dokumenti i orarit mësimor të realizimit të programit mësimorë të ndarë në semestra (orari javor ).</b></li> </ul>



	<p><b>GVJ rekomandon plotësimin e marrëveshjeve, rishikimin e ngarkesës mësimore dhe hartimin e orarit mësimor javor .</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit ka 27 lëndë/ module por GVJ konstatom se <b>janë prezent 23 syllabuse nga 27. Mungojnë syllabuset e gjuhës gjermane viti I dhe viti II, TIK në shkollë dhe shoqëri viti I dhe viti II.</b> Syllabuset janë të organizuar sipas kriterëve të përcaktuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018. Bazuar në ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku titullari i lëndës duhet të jetë i kategorisë Profesor.</p> <p><i>GVJ nga verifikimi i dokumentacioni konstatoi se ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor dhe leksionet zhvillohen nga pedagogë Msc. Bazuar në legjislacionin mbi arsimin e lartë lektorët duhet të jenë të kategorisë doktorë shkencash.</i> Pjesë e programit të studimit është dhe praktika profesionale e cila është 12ETC ose 540 orë mësimore dhe kryhet sipas syllabusit përkatës dhe programit kalendarik në cdo semestër.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon që titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor dhe plotësimi i syllabuseve [dokumenti I planit mësimor, evidence nr 19. syllabuset ].</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që të përshtaten kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale që i shërbejnë si bazë për trajnime dhe kualifikime të mëtejshme. Në kurrikulën e programit përfshihen lëndë specifike për profilet të veçanta të mjekësisë, shkencave sociale dhe kompjuterike (si geriatrit, pediatri, vaksinimi, ndihma e shpejtë, etika në komunikim, etj), që lidhen me nevojat e tregut të punës, lëndë specifike që lidhen me menaxhim të proceseve të punës TIK në shkollë dhe shoqëri, gjuhë të huaja, kurrikula e programit ka një ndërthurje të orëve teorike me ato praktike si orët laboratorët apo praktika profesionale të cilat i shërbejnë aftësimit praktik profesional të studentit. [programi, plani mësimor]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Praktikat profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike, OJF dhe qendra sociale më të cilat UBa ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi si Spitali Universitarë i traumës, Spitalin Salus, QSUNT, urdhri i psikologut të Shqipërisë, urdhri i psikologut të Kosovës, Organizata Save the children, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, etj.</p> <p>Praktika profesionale kryhet sipas udhëzuesit Paketa e programit të praktikës për programet profesionale dhe mbikëqyrjet nga një pedagog udhëheqës i caktuar nga fakulteti dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës, institucioni ku kryhet praktika dhe vetë studenti.</p>



	[evidenca C. udhëzuesi i Paketa e programit të praktikës për programet profesionale, takimi me kordinatorin e programit dhe stafin akademik, takimi me studentë].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

**Standardi II.2**  
**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi.	Programi i studimit profesional OKPSH është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS (ose 60 ECTS në vit) nga të cilat 24 ECTS i përkasin praktikës profesionale. Në programin mësimor nuk përfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm/bazë si dhe nuk vlerësohet ETC apo orë mësimore provimi përfundimtarë.  Në total në të dy vitet akademike programi mësimor realizon 3570 orë mësimore nga të cilat 1740 orë realizohen në auditor. [kurikula e programit, plani mësimor].
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore, sociale, menaxhim të proceseve të punës, zgjidhjen e probleme të vecanta të pacientit dhe përshtatjen e tyre në tregun e punës.  Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit. [rregullorja e programit të studimit, plani mësimor]
<b>Kriteri 3.</b> Planin mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Në programin mësimor studenti gjen informacion për planin mësimor në të cilin përfshihet informacion për ngarkesën mësimorë në ore/ETC për çdo lëndë të ndarë sipas viteve akademike, orët në auditor dhe studimit individual, praktikën profesionale dhe orët laboratorike, frekuentimi nga studentët i programit mësimor, mënyra e vlerësimit, tematikat dhe literaturën e nevojshme bazë dhe ndihmëse [evidenca 7 Rregullorja e funksionimit të programit, tabela plani mësimor].
<b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite konvertuar në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit/punë të pavarur të studentit. Nga shqyrtimi i programit dhe planit mësimor GVJ konstaton shpërndarje promovionale të



	ETC midis lëndëve specifike, lëndëve integruese dhe praktikës profesionale, <b>ku raporti teori praktikë është 50:50</b> . Një vënd të rëndesishëm në programin e studimit profesional për aftësi praktik të studentëve zë praktika profesionale e cila përbën 30% të orëve të programit mësimorë ose 24 ETC. <i>[plani mësimor]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme profesionale.  Me njohuritë e mara në këtë program studentët e ndjejnë veten të aftë për ushtrimin e profesionit të tyre dhe përshtatjen me tregun e punës. <i>[plani mësimor, syllabusët, takimi me stafin akademik dhe studentët].</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht.</b>
				X

### Standardi II.3

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/ lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit përmban informacion të plotë lidhur me tematikën e modulit/ lëndëve teorike dhe formimit praktik. Në kurikulën e tij përfshihen lëndë specifike për profilet të veçanta të mjekësore si ndihma e parë në situta të vecanta, njohuri për pediatriinë, geriatrinë, metodat e komunikimit sipas grup moshës, lëndë specifike që lidhen me menaxhimin e proceseve të punës si dhe aktivitete trainuese dhe edukuese të organizuar nga institucioni, që lidhen me nevojat e tregu të punës. <i>[rregullorja e programi, plani mësimor]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkua/të pritshme nga punëdhënësit.	Tematikat që trajtohen në program i shërbejnë formimit profesional të studentëve në një fushë profesionale mjet specifike në “Operatorë dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” ku dijet në shkencat mjekësore ndërthuren me ato të shkencave sociale duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të tregut të punës.  Zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS, zhvillimi i orëve laboratorike dhe praktikës profesionale ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme për ushtrimin e profesionit të tyre.





	Institucioni, u ka ofruar mundësi studentëve për trajnime apo marrje pjesë në aktivitet të ndryshme ekstrakurrikulare , që janë në funksion të formimit të tyre profesional.
<b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	<p>Gjatë takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare pasi dhe hapja e këtij programi bazohet në eksperiencën Italiane (për shkak të mungesë së eksperinacvë të ngjashme në vëndin tonë) duke ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës për këtë profesion dhe mungesën e profesionistëve të tillë në tregun e punës në Shqipëri. Kjo ju mundëson studentëve punësimin jo vetëm në shqipëri po dhe në vëndet e rajonit dhe vënde të tjera të BE.</p> <p>Programi i studimit ju mundëson studentëve transferimin e tyre në programe të ngjashme jashtë vëndit. Proçesi i transferim dhe njohjes së kreditëve bëhet sipas rregullores së UBa dhe programit të studimit. Njohuritë e mara në këtë program dhe kurikula e tij ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në struktura shëndetësor spitalore, struktura shëndetësore të kujdesit pajlativë, shtëpitë e kujdesit geriatik, OJF që ofrojnë këshillim dhe përkujdesje shëndetësore. <i>(Referuar takimit me stafin drejtues të Uba dhe stafin akademik, programi mësimor).</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	<p>Përmbajtja e programit mësimor dhe Njohuritë e fituar i shërbejnë studentit për përfitim e aftësive dhe kompetencave për të punuar në mënyrë të pavarur, për tu përballur dhe zgjidhur problemetika të lidhura me organizimin e punës, menaxhimin e pacientit për ti shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale, zgjidhjen e situatave komplekse dhe të paparishikuar me pacientin. Gjithashtu njohuritë e fituar në këtë program studimi shërbejnë si bazë për zgjerimin e njohurive në trajnime të tjera profesionale. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, ky program studimi profesionale ju shërben për formimin e tyre profesional dhe aftësimin praktikë për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike shëndetësore apo struktura të shërbimit social. <i>[rregullorja e programi, takimi me studentët].</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	<p>Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione apo organizata të ndryshme të cilat i shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale dhe krijimin e kontaktetëve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre. Këtij qëllimi i shërben dhe ngritja e bordit të karrierës, pranë këtij program studimi i cili shërben marrjes së mëndimit të biznesit për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës. Bashkëpunimi dhe vlerësimi i përbashkët i studentit për praktikën profesionale i shërbejnë formimit dhe aftësimi të tij praktik në përputhje me kërkesat e profesionit dhe tregut të punës.</p> <p><i>[rregullorja e programit të studimit, paketa e praktikës profesionale</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Universiteti Marin Barleti (UBa) ka hartuar rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit. Këto rregullore përcaktojnë elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive.</p> <p>Programi i studimit ka për qëllim të zhvillojë një gamë të plotë aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për zgjidhje krijuese për problemet në fushën e përkujdesjes shëndetësore, sidomos në kategoritë më vulnerabel të shoqërisë, fëmijët, moshën e tretë dhe personat në rehabilitim. Për realizimin e këtij qëllimi programi i studimit parashikon zhvillimin e një numri të madh orësh praktike; 540 orë në auditor – 24 ECTS të ndara në mënyrë proporcionale në 4 semestra. Në funksion të praktikës, institucioni ka lidhur një numër marrveshjesh bashkëpunimi për realizimin e tyre dhe aftësimin profesional të studentëve.</p> <p><b>GVJ rekomandon plotësimin e marrëveshjeve.</b></p> <p><i>(rregulloret, takimi me stafin akademik dhe studentët, tabela përmbledhëse, RVB).</i></p> <p>Institucioni në mënyrë periodike çdo vit vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet realizimit të plotësimin të pyetësorit të vlerësimit nga studentët. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik, problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik si dhe logjistikën në funksion të programit të studimit. Për marrjen e mendimit nga studentët NJSBC organizon takime me fokus grupe të studentëve. Këto takime shërbejnë për marrjen e opinionit të studentëve dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies, monitorimin e procesit mësimor si dhe vlerësimin nga studentët të cilësisë së shërbimeve të mara nga administrata e institucionit.</p> <p>NJSBC përgatit raportin përfundimtar mbi vlerësimin e bërë nga studentët për aktivitetin akademik, kërkimor shkencor dhe shërbimet e ofruara nga institucioni dhe ia vë në dispozicion rektorit dhe senatit akademik. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët bëhen publike për të gjithë stafin akademik në formë të personalizuar.</p> <p>Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimit të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.</p>



	(formulari i vlerësimit, Raporti i vlerësimit të brendshëm, rregullorja e NJSBC rregulloret dhe statuti i institucionit, takimet me studentët dhe NJSBC)																																				
<b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika klinike, laboratore. GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online. Në diskutim me stafin dhe studentët GVJ u informua për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë përmes platformave <i>online</i> dhe mbështetjen e madhe që institucioni iu ka siguruar studentëve dhe pedagogëve në këtë proces dhe në këtë vit të vështirë. Në tabelë paraqitet në mënyrë të detajuar ndarja e orëve sipas formave të mësimdhënies dhe ndarja e tyre në orë në auditor/punë e pavarur e studentit, sipas tabelës së planit mësimor.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Program Profesional në OKPSH</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>Në auditor</b></td> <td><b>870</b></td> <td><b>870</b></td> <td><b>1740</b></td> </tr> <tr> <td>- Leksione</td> <td>300</td> <td>300</td> <td><b>600</b></td> </tr> <tr> <td>- Seminare</td> <td>210</td> <td>210</td> <td><b>420</b></td> </tr> <tr> <td>- Laboratore</td> <td>90</td> <td>90</td> <td><b>90</b></td> </tr> <tr> <td>- Trajnim Praktik</td> <td>270</td> <td>270</td> <td><b>540</b></td> </tr> <tr> <td>- Prova finale</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Punë e pavarur e studentit</b></td> <td><b>758</b></td> <td><b>758</b></td> <td><b>1516</b></td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>1528</b></td> <td><b>1528</b></td> <td><b>3056</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Në shqyrtimin e dokumentacionit GVJ konstaton mospërputhje të ngarkesës mësimore (orë mësimore) të pasqyruara në tabelën e planit mësimor (1740 orë në auditor) me tabelën 13 (1350 orë) dhe tabelën (1260 orë). GVJ konstatoi dhe mospërputhje të orëve mësimore të praktikës profesionale të pasqyruar në tabelën e planit mësimor (135 orë për semestër, total 540 orë) me orët e pasqyruar në ngarkesën e pedagogëve tabelat nr.12 dhe tabelën nr.13.</p> <p><b>GVJ rekomandon rishikimim e ngarkesës mësimore dhe plotësimin e saj.</b></p>	Program Profesional në OKPSH	Viti I	Viti II	Në total	<b>Në auditor</b>	<b>870</b>	<b>870</b>	<b>1740</b>	- Leksione	300	300	<b>600</b>	- Seminare	210	210	<b>420</b>	- Laboratore	90	90	<b>90</b>	- Trajnim Praktik	270	270	<b>540</b>	- Prova finale	-	-	-	<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>758</b>	<b>758</b>	<b>1516</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>1528</b>	<b>1528</b>	<b>3056</b>
Program Profesional në OKPSH	Viti I	Viti II	Në total																																		
<b>Në auditor</b>	<b>870</b>	<b>870</b>	<b>1740</b>																																		
- Leksione	300	300	<b>600</b>																																		
- Seminare	210	210	<b>420</b>																																		
- Laboratore	90	90	<b>90</b>																																		
- Trajnim Praktik	270	270	<b>540</b>																																		
- Prova finale	-	-	-																																		
<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>758</b>	<b>758</b>	<b>1516</b>																																		
<b>Gjithsej</b>	<b>1528</b>	<b>1528</b>	<b>3056</b>																																		
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e	Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët apo prezantimi i temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Staf i akademik																																				



<p>mësimxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>është bashkëpunues dhe mbështetës si në pjesën teorike të zhvilluar në auditor ashtu dhe në zhvillimin e trajnimit praktik në qëndrat me të cilat UBa ka marrëveshje bashkëpunimi. Në rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimdhënës luan dhe koordinatori i departamentit.</p> <p><i>(takimet me studentët, stafin akademik, evidenca 37)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit për vitin 2020 – 2021 përbëhet nga 12 pedagogë prej të cilëve 8 PAE dhe 4 PAK. Sipas kualifikimit personeli akademik përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 pedagogë të kategorisë Profesor</li> <li>- 1 pedagog i kategorisë Doktor</li> <li>- 9 pedagogë të kategorisë Master i Shkencave</li> </ul> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur në lëndët që zhvillon.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe tabelave shoqëruese GVJ konstaton një përmirësim të cilësisë së stafit në vite dhe rregullim të raportit PAE/PAK në mësimdhënie. Në vite konstatohet rritjen e numrit dhe cilësisë së stafit akademik të përfshirë në procesin e mësimdhënies në programin e studimit OPKSH. <b>Për vitin akademik 2018-2019 PAE realizojnë 58% të ngarkesës mësimore dhe PAK realizojnë rreth 42% të ngarkesës mësimore.</b> Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020 -2021 PAE realizojnë rreth 80% të ngarkesës mësimore dhe PAK realizojnë 20% të ngarkesës mësimore.</p> <p><i>GVJ konstaton gjithashtu që pedagogët e kategorisë Master i Shkencave janë lektorë dhe në disa prej lëndëve dhe titullarë lënde. Në 3 raste u konstatua mospërputhje e emrave të pedagogëve midis syllabuseve dhe tabelave përmbledhëse.</i></p> <p><b>Bazuar në konstatimet e mësipërme GVJ rekomandon rishikimin e stafit të angazhuar në mësimdhënie për realizimin e programit mësimor.</b></p> <p><i>(syllabuset, plani mësimor, tabela 4)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese etj. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj.</p> <p>Institucioni ka përgatitur një paketë dokumentash dhe praktikash për realizimin e mësimdhënies on line, për përdorimin e teknologjisë dhe politikat e publikimit.</p> <p><i>(takimet në institucion, evidencat 39, 46, 48)</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	UBa ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë infrastrukturën fizike dhe logjistikën e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimi. Në funksion të procesit mësimor teoriko-praktik janë dhe laboratorët mjekësorë mësimorë të paisur me mjetet e nevojshme për të nxitur punën e pavarur të studentit, dhe aftësimin praktik të tyre. <i>(evidenca 42, vizita në ambientet e universitetit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj në formë elektronike, sistemin online ku ata mund të gjejnë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, leksionet, librat si dhe literaturën e nevojshme. Në përgjigje të situatës pandemike institucioni ka përshtatur programet për mësimdhënien on line përmes platformave google classroom dhe google meet si dhe ka përgatitur për përdorim programe të reja të dedikuara për mësimdhënie on line. <i>(evidencat 46, 48, takimet në institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për programin e studimit gjendet në librarinë dhe bibliotekën e Universitetit e printuar ose në format elektronik. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojë. Për rastet kur mungon literatura ajo ju vihet në dispozicion nga pedagogu në formë elektronike.  GVJ konstatoi se literatura e vënë në dispozicion të studentëve në <i>syllabuse është e vjetër</i> . Në takimin me stafin akademik u argumentua se meqenëse programi është i ri, punohet kryesisht me leksionet e përgatitura nga pedagogët, me video dhe materiale didaktike të përshtatshme.  <b>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës në syllabuse.</b>



	<i>(syllabuset, evidencat e programit të studimit, evidencat 45, 42 për bibliotekën, takimi me stafin akademik dhe studentët)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>UBa ka vënë në funksion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën e cila pasurohet në mënyrë periodike mbështetur në propozimet e departamenteve. Gjatë vizitës në bibliotekë dhe takimet me stafin akademik GVJ konstatoi se në biblioteke dhe librarinë e universitetit gjendet një numër i mjaftueshëm librash si për studentët dhe pedagogët. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik. Biblioteka ka infrastrukturë të duhur dhe zotëron poste leximi, kompjutera, ambienti është i mbuluar me wireles.</p> <p>Institucioni i siguron studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë. Platforma on line e bibliotekës së UBa u siguron përdoruesve (pedagogë dhe studentë) shfrytëzimin e 23 burimeve të ndryshme bibliotekash on line. Abonimi në Jstor në llogarinë <a href="mailto:library@umb.edu.al">library@umb.edu.al</a> ka shtuar mundësitë për shfrytëzimin e artikujve të publikuar në revista akademike.</p> <p><i>(evidencat 42/1, 45, 42/c, vizita në ambientet e bibliotekës dhe takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Në kampusin e ri të UBa njësia e laboratorëve është konceptuar si një ambient i integruar i paisur me infrastrukturën e nevojshme në funksion të realizimit të temave të laboratorëve, detyrave të kursit, aftësimi praktik të studentëve. Njësitë laboratorike ofrojnë mundësi dhe për kryerjen e diplomave dhe studimeve specifike.</p> <p><i>(Infrastruktura e programit të studimit, vizita në ambientet e laboratorëve)</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Në funksion të mësimdhënies sidomos në kushtet e pandemisë UBa ka fuqizuar dhe instiotucionalizuar përdorimin e platformave të mësimdhënies on line. Për çdo lëndë/modul, pedagogët kanë krijuar klasat e tyre në google classroom ku janë hedhur të gjitha materialet studimore (leksione, video demonstruese etj) në funksion të përdorimit praktik nga studenti. Në takimin me studentët u informuam se ata janë instruktuar dhe e kanë përdorur me efikasitet platformën on line të mësimdhënies në kushtet e pandemisë.</p> <p><i>(takimet me stafin akademik dhe studentët)</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka krijuar (vendim senati Nr. 58 datë 10.03.2021) dhe ka në funksionim NJSBC që është komision i përhershëm që siguron orientimin, këshillimin, mbështetjen dhe hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë. Në UBa funksionon dhe njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe cilësisë që ka qëllim monitorimin, vlerësimin, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC kryen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrativ. NJSBC monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik bazuar në pyetësorin e studentëve rreth aftësive mësimdhënëse të pedagogëve dhe logjistikës në dispozicion të procesit mësimor, ndjekjen e orëve mësimore në auditor, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit. NJSBC-ja harton raporte vjetore të cilat janë detyrim institucional. <i>(evidencat 8, 39, 40, takimet me NJSBC dhe studentët)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, pjesë e Fakultetit të Shkencave sociale, turizmit dhe sporteve në Universitetin Marin Barleti.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të mësimit në programin e studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore”. Departamenti në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Fakultetit përcakton nevojat për staf akademik, propozon kriteret për përzgjedhjen e tyre në procesin mësimor, propozon shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas ekspertizës dhe kompetencës profesionale, miraton syllabuset, monitoron realizimin e procesit mësimor sipas plani të miratuar, vlerëson procesin e mësimdhënies etj.</p> <p><i>(evidencat 37, 38, takimi me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe</p>	<p>Personeli akademik dhe efektiv dhe me kontratë si dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e këtij programi studimi dhe janë të angazhuar në përmirësimin</p>



angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja në përputhje me specifikën e këtij programi profesional. Në takimin me stafin akademik u informuam se institucioni ka një politikë mbështetëse dhe stimuluese për pedagogët Msc. në funksion të kualifikimit të mëtijshëm akademik të tyre.  <i>(takimi me stafin akademik, plani mësimor, rregullorja e programit të studimit)</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, realizimin e botimeve, pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore.  Institucioni ka organizuar trajnime të vazhdueshme me stafin për përdorimin me efikasitet të platformave on line të mësimdhënies. Institucioni ka inkurajuar vazhdimisht dhe trajnimin e personelit akademik në institucione Europiane përmes programeve të shkëmbimit dhe projekteve të përbashkëta. <i>(takimet në institucion)</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në zhvillimin e procesit mësimor, duke u mbështetur në lirinë akademike pedagogu teston metoda të ndryshme mësimdhënie sipas lëndëve të veçanta. Metodatat e IT mundësojnë përdorimin e mjeteve ndihmëse që lejojnë bashkëpunimin student pedagog. Studentët referuan që variabilitet metodash kanë sidomos në zhvillimin e seanceve praktike. <i>(takimet në institucion)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit, në syllabuse dhe planin mësimor shkruhen qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, detyrimet që duhet të përmbushen për të hyrë në provim, mënyra e zhvillimit të provimit dhe të dhënat mbi dokumentimin e vlerësimit (procedura e ankimmimit dhe rivlerësimit). Në takimin me studentët GVJ diskutoi dhe mbi mënyrën e informimit për vlerësimin në



	<p>provime me email apo përmes sistmit të brendshëm të informacionit.</p> <p><i>(Rregulloret e institucionit, rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët)</i></p>															
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/ praktika, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Proçedura e testimit të njohurive mbështetet në Rregulloret e institucionit dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>(RVB, takimet me stafin, rregulloret)</i></p>															
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve/ moduleve të përgatitura nga titullari i lëndës shkruhet qartë metodologjia e vlerësimit të njohurive. Studentët informohen që në fillim për kushtet e frekuentimit, detyrimet për t'u plotësuar dhe kriteret e vlerësimit.</p> <p>Në programin mësimor të “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” një vend të rëndësishëm zë dhe proktika për përfitimim e aftësive profesionale. Institucioni ka përgatitur “Paketën e praktikës” në të cilën detajohet procedura e vlerësimit të studentit në të gjithë komponentët e saj duke filluar nga frekuentimi, cilësitë etike dhe aftësitë e ndryshme profesionale (sipas lëndëve).</p> <p><i>(rregulloret, syllabuset, paketa e praktikës)</i></p>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Institucioni realizon testimet dhe vlerësimin e njohurive në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Me shkrim</li> <li>- Me gojë</li> <li>- Testim elektronik (shumë i përdorur në pandemi)</li> </ul> <p>Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që studenti merr gjatë gjithë semestrit/akademik. Në varësi të tipit të lëndëve, në syllabuse gjejmë dy tipe vlerësimi:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Tipi i Vlerësimit</th> <th>Varianti 1 (%)</th> <th>Varianti 2 (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi ndërmjetëm</td> <td>20%</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Praktikë</td> <td>-</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Aktivizimi</td> <td>10%</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Detyra kursi</td> <td>20%</td> <td>40%</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi i Vlerësimit	Varianti 1 (%)	Varianti 2 (%)	Provimi ndërmjetëm	20%	-	Praktikë	-	10%	Aktivizimi	10%	10%	Detyra kursi	20%	40%
Tipi i Vlerësimit	Varianti 1 (%)	Varianti 2 (%)														
Provimi ndërmjetëm	20%	-														
Praktikë	-	10%														
Aktivizimi	10%	10%														
Detyra kursi	20%	40%														



	<b>Provimi përfundimtar</b>	50%	40%
	<b>Detyrimi frekuentimi</b>	50% për leksione 75% për seminare	80% të orëve
	<p>Praktika vlerësohet sipas modaliteteve të përshkruara në rregulloren e praktikës.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullore përkatëse. Elemente kryesore të kontrollit të dijeve janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në tre sezona: sezoni dimrit, verës, vjeshtës.</p> <p><i>(rregulloret, syllabuset)</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Testimi i dijeve përfundimtare realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar lëndën. Komisioni i vlerësimit të provimit përbëhet nga dy pedagogë kur lënda ka më shumë se një pedagog. Komisioni i vlerësimit miratohet nga dekan.</p> <p><b>GVJ rekomandon që komisioni i provimit të jetë me dy pedagogë.</b></p> <p>Vlerësimi i dijeve bëhet sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemit me notë: nga 1 – 10 (nota kaluese 5/ vlerësimi maksimal 10)</li> <li>- Sistemit me pikë: 1 – 100 (nota kaluese &gt;50/ vlerësimi maksimal 96 – 100)</li> <li>- Sistemi me shkronjë: A – F (vlerësimi maksimal A; vlerësimi jokalue F)</li> </ul> <p>Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e procesit mësimor por dhe me numrin e ECTSve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që student duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi.</p> <p><i>(rregulloret, syllabuset)</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Studentëve iu garantohet e drejta për rishikim dhe ankimim për vlerësimin e provimit. Ankimimi duhet kryer brenda 48 orësh nga marrja e rezultatit dhe para regjistrimit përfundimtar të rezultatit në regjistrin e arritjeve akademike. Ankesa verifikohet në departament dhe nëse nuk gjendet zgjidhje, ankesa i kalohet Dekanit që ngre një komision ad-hoc për shqyrtimin e saj. Vendimi që merret pas rishqyrtimit</p>		



	nga dekani është i pakontestueshëm. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet në institucion.  (rregulloret e institucionit dhe rregullorja e programit të studimit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxëniet për programet me karakter profesional.	<p>Programi i studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” që ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe shëndetit në UBa përgatit specialistë për një fushë specifike të shërbimit mjekësor-komunitar për të cilën tregu ka shumë nevojë. Ky program ofrohet vetëm nga UBa.</p> <p>Megjithëse institucioni nuk ka kryer një studim të mirëfilltë tregu, në diskutimin me stafin drejtues të njësisë kryesore dhe të programit si dhe me GVB u informuam se programi synon përgatitjen e profesionistëve të aftë dhe kompetentë për asistencë në grupe vulnerabel të popullatës si të moshuarit, fëmijët apo personat me nevoja specifike. Gërshetimi në programin mësimor i njohurive mjekësore dhe psikologjike garanton përfitim e njohurive për zhvillimin e aftësive të veçanta profesionale të këtij programi me karakter profesional.</p> <p>(takimet në institucion)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	<p>Në këtë program studimi zhvillohen lëndë me karakter mjekësor-human që i paisin studentët me njohuri teoriko-praktike dhe aftësi ndërvepruese në fushat specifike të geriatrisë, pediatriisë apo rehabilitimit shëndetësor. Lëndët mjekësore integrohen me njohuritë në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit përmes të cilave synohet formimi i shprehive etike në komunikim dhe punë në grup, formimi i shprehive në përdorimin e teknologjisë në funksion të profesionit si dhe shprehive menaxheriale. Lëndët e gjuhës së huaj (anglisht dhe gjermanisht) i shërbejnë formimit të përgjithshëm profesional duke lehtësuar shfrytëzimin e literaturës si dhe janë në funksion të mobilitetit dhe punësimit brenda e jashtë vendit.</p> <p>(programi mësimor, plani mësimor, takimet me RVB, stafin dhe studentët)</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për realizimin e këtij programi mësimor me karakter profesional, institucioni ka lidhur një seri marrëveshjes me aktorë të rëndësishëm që operojnë në fushën e kujdesit shëndetësor si spitale universitare, qendra të shërbimit komunitar dhe shoqata.</p> <p>Në seancët praktike në institucionet e mësipërme stimulohet bashkëveprimi i studentëve me profesionistët me përvojë dhe ekspertizë për analizimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete. Ndërthurja e formave të mësimdhënies (teori në auditor dhe analizë e rasteve praktike) është në funksion të formimit cilësor dhe nxitjes së mobilitetit të studentëve. Në takimin me studentët GVJ u informua se një pjesë prej tyre synojnë të punësohen në institucione të ofrimit të shërbimit jashtë Shqipërisë.</p> <p><i>(programi mësimor, marrëveshjet për zhvillimin e praktikës)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimi pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Veçori e vlerësimit të praktikës është vlerësimi veç aftësive dhe i etikës dhe përgjegjshmërisë, cilësi të domosdoshme për specialistin e ardhshëm.</p> <p><i>(takim me stafin dhe studentët, RVB, evidenca 38)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në nenin 16 të rregullores së programit të studimit theksohet se për të fituar Diplomë Profesionale në "Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore" studenti duhet të ketë siguruar 120ECTS. Prova finale është në formën e një provimi të përgjithshëm përfundimtar. Në rregullore theksohet se procedurat për provën finale përcaktohen në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>GVJ konstatoi se procesi i diplomimit nuk përfshihet në detyrimet përmbyllëse të programit mësimor siç rekomandon VKM 185 datë 25.03.2021. <b>GVJ kërkoi dhe nuk u njoh me rregulloren e diplomimit.</b> Në takimin me GVB u informuam se në planin e ri mësimor do të përfshihen dhe të dhënat për diplomimin që ne kërkuam. Institucioni ende nuk ka përgatitur Formatin dhe Supplementin e Diplomës.</p> <p><b>GVJ rekomandon riorganizimin e programit mësimor sipas VKM 185 datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 41 datë 24.1.2018 "Për elementet e</b></p>



	<p><b>programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar.</b></p> <p>Institucioni ruan dhe përditëson në fund të cdo viti akademik informacionin për ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve pranë Sekretarisë mësimore. GVJ verifikoi dokumenta të sekretarisë mësimore (regjistri i notave, regjistri themeltar, fletët e provimit, dosje studenti) dhe i gjeti të plotësuar konform ligjit.</p> <p><i>(rregullore e programit të studimit, rregullore e sekretarisë mësimore, takimi me GVB, dhe sekretarinë mësimore)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Programi i studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” është program profesional në të cilin nuk parashikohet përgatitje e punimit të diplomës.</p> <p><i>(rregullore e programit të studimit)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Në UBa është ngritur dhe funksionon sipas rregullores specifike Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBN) e cila ka në fokus hartimin e politikave dhe strategjisë për rekrutimin e stafit të kualifikuar në funksion të specifikave të programeve të studimit. Në takimet në institucion GVJ u njoh me procedurën konkrete të rekrutimit të stafit akademik. Kërkesa për staf akademik bëhet nga Departamenti. Proçedura është transparente. Shpallet vakanca (pozicioni, kriteret, afati i aplikimit) në web (<i>evidenca 18</i>). ZMBN mbledh aplikimet dhe ngre komisionin që seleksionon kandidatët sipas dokumentacionit. Me tej kandidatët thirren për intervistë në të cilën veç përfaqësuesve të ZMBN është dhe ZvRektori dhe Drejtuesi i departamentit dhe specialist të fushës.</p> <p>Kohëzgjatja e kontratave të punës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- PAE i kategorisë Msc: 1 vit</li> <li>- PAE i kategorisë Dr/Prof: pa afat</li> <li>- PAK: semestrale me të drejtë rinovimi</li> </ul> <p>(<i>evidencat 11, 18, takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimesh-kencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UBa disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit "Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore". Të dhënat e plota të stafit akademik gjendet pranë ZMBN në dosjet personale.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ, listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje në mënyrë rastësore, një nga personeli akademik efektiv dhe një me kontratë të cilat rezultuan të kompletuara, konform rregullave dhe kriterëve institucionale.</p> <p>(<i>evidenca 11, 44, dokumentacioni i verifikuar në mënyrë rastësore</i>)</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar në këtë program staf akademik me përvojë dhe ekspertizë në fushat përkatëse. GVJ konstatoi se një pjesë e lektorëve janë të kategorisë Msc (rekomandim te standarti III/1/4).</p> <p>Me anë të koordinatorit të programit Institucioni realizon optimizimin dhe menaxhimin e tërë procesit akademik dhe shkencor në funksion të programit të studimit.</p> <p>Mjedisi i krijuar përbush pritshmëritë për realizimin e një procesi mësimor cilësor dhe për zhvillimin e formave interaktive të mësimdhënies (video, diskutime në grup, detyra kursi etj)</p> <p><i>(evidenca 36, CV e pedagogëve, tabelat e programit të studimit, vizita në institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni mbështet dhe inkurajon personelin akademik Msc. për kualifikimin e mëtejshëm në procesin e Doktoraturës.</p> <p>Institucioni nxit angazhimin e personelit akademik në projekte kërkimore shkencore me fokus zhvillimin ekonomik, social, politik, shkencor etj.</p> <p>Në institucion vërehet frymë positive dhe stimuluese për prezantimin e arritjeve në formën e referimeve apo publikimeve në revistat shkencore.</p> <p>Institucioni mbështet stafin dhe përmes trajnimeve siç janë trajnimet për metodat e reja të mësimdhënies dhe mësimdhënien on line. <i>(takimi me stafin, GVB, evidenca 39, 43)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni është i organizuar në formën e 2 Kampuseve Universitare (3 godina). Kampuset janë të vendosura larg zonave industriale dhe janë organizuar në mënyrë të tillë që të krijojë siguri dhe njëkohësisht lirëshmëri lëvizje për studentët.</p> <p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</p> <p><i>(evidencat 42, 42/1, vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje</p>	<p>Në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të</p>



<p>elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>stafit dhe studentëve, zyrat për stafin, biblioteka si dhe hapësirat e tjera rekreative.</p> <p>Ambjentet janë me sistem kondicionimi dhe sistem wireless, nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet, tabela dhe foni. Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura gjithashtu me mjete audio vizive si PC, projektorë. Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.</p> <p><i>(RVB, evidenca 42/1, tabela 16, vizita në institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në hapësirat e Kampusit 2 laboratorët në funksion të programit të studimit (anatomi, biokimi, infermieri etj.) janë vendosur në një hapësirë që siguron bashkërendim të punës në funksion direkt të zhvillimit të programit mësimor.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve dhe konstatoi se ato ishin të mirëpaisur për plotësimin e kërkesave të moduleve për aftësimin teoriko-praktik të studentëve.</p> <p><i>(RVB, evidenca 42/1, vizita në institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Në takimet me stafin u informuam se institucioni disponon 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit të paisur me programe profesionale. Këto laboratorë janë në funksion të mësimdhënies por dhe të punës kërkimore dhe projekteve të institucionit.</p> <p><i>(takimet me GVB dhe stafin)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” përgatit profesionistë me njohuri të gjera praktike në menaxhimin e rasteve të asistencës geriatrike, rehabilituese apo asistencës për fëmijët.</p> <p>Veç ambienteve mësimore të kampusit universitar, studentëve iu ofrohet (përmes marrëveshjeve dypalëshe) mundësia e praktikës në sistemin spitalor, në institucione me fokus përkujdesjen ndaj kategorive të mësipërme si dhe në shoqata që asistojnë këto komunitete. <i>(evidencat 32, 41, takimet në institucion)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është e organizuar në disa njësi dhe siguron mundësi shfrytëzimi të barabartë dhe pa kufizime, pa pagesë për studentët.</p> <p>Në Kampusin 1 ka një hapësirë bibliotekë (40m<sup>2</sup>) me 18 poste leximi.</p> <p>Në kampusin 2 biblioteka organizohet në tre njësi funksionale :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Njësia 1: 27.3m<sup>2</sup> me 18 poste leximi. Kjo njësi shërben si bazë për arkivimin e librit fizik</li> <li>– Njësia 2: 95.1m<sup>2</sup> me 50 poste leximi. Kjo njësi veç librit fizik krijon mundësi përdorimi të periodikëve dhe revistave shkencore. Një pjesë e posteve në këtë njësi janë të paisura me kompiuter për akses direkt në bibliotekën on line.</li> <li>– Njësia 3: 70m<sup>2</sup> me 28 poste leximi. Kjo njësi ka të njëjtën strukturë me njësinë 2.</li> </ul> <p>Biblioteka ofron një fond fizik prej 5250 titujsh. Biblioteka ofron për përdoruesit mundësi të shumta eksplorimi të literaturës on line përmes 11 programeve të aksesueshme prej saj. Biblioteka ofron dhe katalogun digital. <i>(evidencat 41/1, 45, vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentacionin e bibliotekës dhe në vizitën në ambientet e saj konstatoam se në bibliotekë gjenden të depozituara librat e rekomanduar në syllabuset e programit të studimit. Ndërkohë që 126 janë titujt që i përkasin programeve të studimit me natyrë mjekësore në përgjithësi.</p> <p><i>(evidenca45, vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ka një numër optimal postesh leximi për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në fondin fizik dhe në bibliotekat on line.</p> <p>Institucioni ka siguruar gjithashtu akses nga platformat individuale të studentëve dhe pedagogëve në bibliotekën digitale JSTOR dhe në disa biblioteka të tjera. Kjo shton mundësinë për punë të pavarur sidomos në eksplorimin e publikimeve në revista e periodikë.</p> <p>Në takimin me punonjësit e bibliotekës u informuam se fondi i literaturës së detyruar sipas syllabuseve është plotë në bibliotekë. Institucioni ka një politikë përditësimi dhe shtimi të fondit ekzistues në mbështetje të këtij programi por dhe programeve në</p>



	<p>tërësi. Propozimi për libra të rinj paraqitet i argumentuar nga shefat e departamenteve dhe më tej i drejtohet zyrës së financës.</p> <p><i>(evidenca 45, takimet në institucion)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme pritëse për të realizuar programin teorik dhe praktikat laboratorike. Ambientet garantojnë cilësi në mësimdhënie dhe në realizimin praktikave laboratorike dhe diskutimeve teoriko-praktike. Institucioni ka lidhur një seri marrëveshjesh me institucione spitalore, dhe komunitare që garantojnë mbështetje logjistike për formimin e plotë profesional të studentëve. Bashkëpunimi realizohet i mbështetur në marrëveshje dhe organizohet përmes rregullores së përmbledhur në dokumentin “Paketa e praktikës”.</p> <p><i>(evidencat 42, tabelat e programit të studimit, marrëveshjet me partner për praktikën, paketa e praktikës)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>UBa administrohet nga shoqëria Barleti grup sh.p.k. aktiviteti i të cilit deklarohet në zhvillimin e studimeve universitare dhe pasuniversitare dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot financiare për programet e studimit në UBa dhe raportet financiare vjetore përpilohen nga Zyra e Financës nën drejtimin e Administratorit të Deleguar.</p> <p>Në planin e financimit të programeve të <b>studimit (nuk është paraqitur plan i veçuar për këtë program)</b> theksohet se burimi kryesor i financimit janë tarifat studimi të cilat rezultojnë të qëndrueshme në vite duke garantuar vazhdimësi. Një zë në rritje në tabelën financiare rezulton të jetë zëri “konsulenca dhe shërbime”. Po ashtu rritje në dy vitet e fundit ka patur zëri “shërbime trainuese”. Në takimet me stafin u konstatuan pritshmëritë për shtimin e financimeve dhe përmes pjesmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>(evidencat 49, 50)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Në raportin financiar vjetor dhe në planin e financimit, institucioni deklaron se garanton mbulimin e të gjitha veprimtarive në funksion të realizimit të programit të studimit. Institucioni deklaron se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit të demonstruar në tabelat shoqëruese të raportit financiar vjetor.</p> <p><i>(evidencat 49, 50)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloret e UBa janë përcaktuar qartë politikat, procedurat, kriteret e pranimit të studentëve, përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit.</p> <p>Informacioni i përditësuar iu bëhet me dije studentëve përmes faqes web të institucionit dhe portalit studentor duke siguruar akses të barabartë dhe të drejta të barabartë për kandidatët dhe studentët në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Përmes portalit studentor, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe për ecurinë akademike të tyre.</p> <p><i>(statuti dhe rregulloret e institucionit, evidencat 48a dhe 48b)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret, kuotat për çdo program studimi publikohen në faqen zyrtare të institucionit <a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a>. Në këtë faqe publikohen gjithashtu procedurat e pranimit, ku jepet informacioni i nevojshëm që nga aplikimi, rregjistrimi dhe matrikullimi, GVJ gjykon se informacionet janë të sakta dhe transparente.</p> <p><i>(portali zyrtar i UBa, takimi me studentët)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Në aktet rregullatore të UBa, rregulloret e programit të studimit, rregulloret e fakultetit etj. janë evidentuar qartësisht, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, vlerësimit, diplomimit si dhe modalitetet e transferimit nga shkolla të tjera universitare dhe njëkohësisht modalitetet e transferimit të studentëve të UBa drejt shkollave të tjera universitare. Po ashtu, studentët kanë informacion për mundësitë e kryerjes së veprimtarive praktike dhe institucionet bashkëpunuese ku mund t'i realizojnë ato.</p> <p>Pikë e rëndësishme kontakti për studentët është Dekania e studentëve e cila është pranë tyre në çdo kohë, me qëllim asistencën e tyre gjatë tërë periudhës së studimit deri në diplomim. Sekretaria mësimore luan rol gjithashtu në informimin e studentëve për orarin e mësimin, provimeve dhe çdo detaj në lidhje me procesin akademik.</p> <p>Në funksion të informimit të studentëve është dhe portali studentor dhe platformat e tjera LMS dhe Classroom.</p> <p><i>(rregulloret e institucionit, faqja ëeb, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përmban informacionin e plotë dhe informon studentët mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>



dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Institucioni përmes zyrës ALUMNI përditëson të dhënat e punësimit të studentëve dhe organizon aktivitete për dhënie eksperience, orientim dhe punësim të studentëve të rinj.</p> <p>Në takimin me studentët u insistua për promovimin i programit për të tërhequr një numër më të madh studentësh.</p> <p><i>(rregullorja e programit të studimit, faqja ëeb, takimet në institucion)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Përmes koordinatorit të programit dhe Sekretarisë Mësimore studentët informohen në lidhje me programin e studimit dhe planin mësimor të cilët përmbajnë informacionin për kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite.</p> <p>UBa ve në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëve/moduleve, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, informacione të cilat janë gjithmonë të përditësuara. Studentët kanë kontakte të vazhdueshme me stafin akademik dhe Dekanin e studentëve për zgjidhjen në kohë të problematikave. Informacionet dërgohen elektronikisht si dhe gjenden të pasqyruara fizikisht në vende të dukshme në formën e orarit, kalendarit të provimeve apo njoftimeve të ndryshme.</p> <p><i>(rregullorja e programit të studimit, faqja ëeb, takimet në institucion)</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Institucioni ka ndërtuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik përmes logimit me kredencialet individuale.</p> <p>Në platformat e mësimdhënies në google classroom studentët gjejnë gjithashtu informacion të detajuar mbi lëndët, modulet, materialet mësimore, syllabuset, vlerësimet etj. Ky sistem ka bërë të mundur funksionimin real të mësimdhënies në kohën e pandemisë. Komunikimi me email është një tjetër dritare informimi të shpejtë dhe në distancë. <i>(platformat on line, takimet në institucion)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre	UBa ka ndërtuar një sistem të brendshëm menaxhimi të informacionit që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi në diplomimi. Informacioni transmetohet në formë shkresore dhe elektronike.



nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Sekretaria mësimore ruan bazën e plotë të të dhënave në formën e regjistrave dhe dokumentacioneve “hard copy” konform legjislacionit në fuqi, përcaktuar nga Udhëzimi i MASR Nr.31 MASR/2014. Institucioni përdor sistemin on line ESSE3 për menaxhimin e informacionit mbi lektorin dhe grupet e studentëve (mesimdhënie, frekuentim, vlerësim).  <i>(takimet në institucion, dokumentacioni i konsultuar në sekretarinë mësimore)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ka të skeduar informacionin dhe dokumentacionin mbi aktivitetin e personelit akademik, ndihmësakademik, administrative si dhe informacion për marrëveshjet dhe partnerët e angazhuar në programin e studimit. Mjet i rëndësishëm për komunikim transparent të informacionit janë dhe emaillet zyrtare. Zyra e IT asiston menaxhimin e informacionit dhe trainon personelin dhe studentët për përdorimin e sistemit. Në kushtet e pandemisë, janë shtuar dhe platformat mesimdhënëse on line.  <i>(RVB, dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Aksesi i studentëve në informacionet akademike realizohet përmes portamit studentor ku ata logohen me kredencialet individuale. Komunikimi me email është një mënyrë tjetër transmetimi informacioni tek studentët.  <i>(RVB, dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik janë dhe platformat on line që sigurojnë komunikim, marrje informacioni dhe bashkëveprim në distancë.  GVJ u informua se këto platforma e veçanërisht google classroom u përdorën me efikasitet të lartë gjatë 2 viteve të pandemisë (2019 – 2020, 2020 – 2021) për realizimin e procesit mësimor dhe bashkërendimin e aktiviteteve lektor-student.  <i>(RVB, dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi kompjuterik ofron mundësinë e monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sistemi krijon mundësi për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore në lidhje me aktivitetin mësimor të studenteve, statusin e tyre akademik dhe gjithashtu progresin dhe suksesin e tyre në kohë reale. Këto informacione shërbejnë si bazë për përpilimin e raporteve periodike të aktivitetit nga NJSBC.  <i>(RVB, dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të	Faqja zyrtare e internetit <a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a> ka të gjithë informacionet për programet e studimit, personelin akademik, aktivitetin shkencor, jetën studentore, ndërkombëtarizimin etj dhe mund të aksesohet në gjuhën shqipe por dhe në gjuhën angleze.



paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	(faqja zyrtare : <a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a> )			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>UBa është institucion jo publik i arsimit të lartë i cili bazon aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi dhe dekretet e përvitëshme të cilat dalin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” është hartuar në përputhje me objektivat e programit të studimit duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>(statuti dhe rregulloret e institucionit, rregullorja e programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për pranimin dhe regjistrimin e studentëve në Programin Profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” Institucioni bazohet në udhëzimet e MASR dhe të maturës shtetërore, duke zbatuar jo vetëm procedurat por edhe afatet përkatëse. Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët studentë të këtij programi studimi. Institucioni ofron bursa studimi për studentë me mesatare të lartë (&gt;8.5) dhe për studentë me përkrahje sociale. Kriteret e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Në takimin me studentët GVJ u informua se 2 studente të këtij programi përfitonin bursë si mbështetje sociale.</p> <p><i>(statuti dhe rregulloret e institucionit, rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit publikohen çdo vit kriteret, kuotat për çdo program studimi, procedurat e pranimit dhe informacioni i nevojshëm që nga aplikimi, regjistrimi dhe matrikullimi, GVJ vlerëson se informacionet janë të sakta dhe transparente.</p> <p>Kriteret e pranimit në Programin Profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Kriteret e pranimit lidhen me përmbushjen e detyrimeve të maturës shtetërore dhe pagesën e tarifës së shkollimit. <i>(rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit gjendet informacion i plotë dhe i detajuar për procedurat dhe kriteret e përparimit akademik të</p>



<p>të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>studentëve, procedurat e transferimit, frekuentimit, ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve.</p> <p>Java e parë shërben si javë informimi ku studenti njihet me dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet që ofron institucioni.</p> <p>Koordinatori i departamentit, dekani i studentëve dhe sekretaria mësimore janë vazhdimisht në kontakt me studentët për orientimin dhe informimin e tyre. Koordinatori i programit është pranë studenteve në çdo kohë, me qëllim asistencën e tyre gjatë tërë periudhës së studimit deri në diplomim. Sekretaria mësimore informon studentet për orarin e mësimit, provimeve dhe çdo detaj në lidhje me procesin akademik.</p> <p><i>(rregullore e programit mësimor, takimet në institucion me studentët, sekretarinë mësimore, dekanin e studentëve)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuse janë përshkruar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Në rregullore përcaktohet dhe mënyra dhe kushtet e diplomimit. Studenti merr diplomën pasi realizon 120 ECTS dhe mbron provën finale (provim i përgjithshëm). <i>(rregullore e programit të studimit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni publikon periodikisht dhe përditëson informacionin mbi kriteret specifike dhe të përgjithshme të programeve të studimit në faqen web. Informacioni shpërndahet dhe përmes publikimeve në formë broshurash e fletëpalosjesh, pjesmarrjes në panaire, apo publikimeve në mediat audio-vizive.</p> <p><b>Në takimin me studentët u theksua nevoja për promovim më të mirë të këtij programi studimi që gjykohet i rëndësishëm për tregun e punës dhe komunitetin.</b> <i>(faqja zyrtare, takimi me studentët)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë</p>	<p>Studentët që ndjekin programin mësimor “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Në dosjen e programit të studimit ata gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit</li> <li>– Informacion për objektivat formuese të programit</li> <li>– Strukturën dhe organizimin e programit</li> <li>– Planin mësimor</li> </ul>



<p>formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>– Syllabuset – Rregulloren e programit të studimit Studentët informohen dhe për paketën e praktikës, komponent mjaft i rëndësishëm i formimit të tyre profesional. Në informimin e studentëve veç strukturave administrative të UBa dhe materialeve promocionale të prodhuara nga institucioni kanë rol dhe organizimet studentore të pranishme në formën e klubeve studentore në UBa.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Praktika profesionale është komponent i rëndësishëm i programit dhe planit mësimor. Referuar tabelave të programit të studimit, praktika realizohet e ndarë në 4 semestra dhe ka 24 ECTS të realizuara në 540 orë në auditor (6 ECTS-135 orë në çdo semestër). Studentët orientohen për kryerjen e praktikave pranë institucioneve me të cilat UBa ka marrëveshje bashkëpunimi.  Zyra e ALUMNI dhe e karrierës mbështetin studentin dhe orientojnë në drejtim të tregut të punës. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe gjithë informacionin që merr nga agjensi punësimi, megjithëse i mungojnë statistikave të sakta. Pjesëmarrja në panairin “Work and study” është një risi në këtë fushë.  <i>(paketa e praktikës, marrëveshjet e bashkëpunimit, takimi me përfaqësues të zyrës ALUMNI)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në dosjen e programit të studimit studenti informohet dhe për infrastrukturën e programit të studimit. Numri i klasave dhe laboratorëve është optimal dhe nga vizita në universitet konstatohet që janë OK. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në institucione spitalore dhe të ofrimit të kujdesit specifik. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. Studentët kanë komunikim të vazhdueshëm me Koordinatorin e departamentit, Dekanin e studentëve dhe Sekretarinë mësimore për informim rreth detajeve të procesit mësimor. Komunikimi me email vlerësohet dhe aplikohet si mjet i shpejtë dhe efikas komunikimi në distancë.  <i>(dosja e programit të studimit, vizita në universitet, marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në RVB theksohet se UBa ka një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment. Veç detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. platforma në dy vitet e fundit i ka shërbyer mësimi on line. Në platformën google classroom studentët mund të marrin informacionin në lidhje me lëndët/modulet lehtësisht në distancë. <i>(evidenca 39, takimet në institucion)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	<p>Në sekretarinë mësimore të UBa janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ konsultoi në sekretari:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrin themeltar të studentëve</li> <li>- Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)</li> <li>- Fletë provimi</li> <li>- Dosje të studentit</li> </ul> <p>Dokumentacioni u gjet i plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore. <i>(takimet në institucion, konsultimi me dokumentacionin e sekretarisë mësimore)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit.</p> <p>Në programin e studimit me karakter profesional “Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore” janë regjistruar sipas viteve:</p> <p>Viti shkollor 2018 – 2019: 8 studentë</p> <p>Viti shkollor 2019 – 2020: 12 studentë</p> <p>Viti shkollor 2020 – 2021: 4 studentë</p> <p>Viti shkollor 2021 – 2022: asnjë studentë i regjistruar</p> <p>Në vitin 2020 – 2021 janë 6 studentë që kanë përmbyllur detyrimet akademike ndërsa 1 student është çregjistruar.</p> <p>Në vitin 2021 – 2022 janë 4 studentë në pritje të përfundimit të detyrimeve akademike ndërsa 13 studentë kanë detyrime akademike të papërfunduara.</p> <p><i>(takimet në institucion, tabelat e programit të studimit 21, 23)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	<p>GVJ konstaton se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi deri në diplomim. Informacioni për ecurinë akademike depozitohet pranë Sekretarisë Mësimore ku ruhet në formën e regjistrave të shkruar si dhe në formë elektronike. <i>(takimi në sekretarinë mësimore)</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Dokumentacioni në formë të shkruar ruhet i sigurtë në arshivën e Sekretarisë Mësimore. Të dhënat elektronike menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Ato janë të aksesueshme për studentët përmes portalit studentor. Përmes përdorimit të kredencialeve individuale studentët informohen në kohë reale për rezultatet akademike dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për ta. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e këtij informacioni si dhe përpilimin e raporteve statistikore me kërkesë të Dekanit apo Përgjegjësit të Departamentit. <i>(takimi në sekretarinë mësimore)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore. Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e raporteve shfrytëzohen në nivel të Departamentit e më gjerë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies me fokus cilësi më të mirë studentësh të diplomuar me mundësi më të madhe punësimi.</p> <p>Të dhënat për punësimin e studentëve përditësohen ngë zyra Alumni dhe Karrierës. <i>(evidencat 13, 38)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UBa. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UBa, në Këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta, në NJSBC. Studentët organizohen në Këshillin studentor. Studentët kanë qenë pjesmarrës dhe në hartimin e RVB. Departamentet organizojnë mbledhje të hapura me pjesmarrjen e studentëve. <i>(RVB, statuti, rregulloret)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (kriteri 1) por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetsorë në mënyrë periodike për secilën lëndë dhe pedagogë. Pyetsorët pregatiten dhe informacioni i mbledhur përpunohet nga NJSBC. Studentët shprehen të kënaqur për komunikimin me stafin akademik dhe</p>





	ndihmësakademik në institucion. (evidencat 8, 37, takimi me studentët dhe NJSBC)			
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi dhe respekton në përgjithësi kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. <b>GVJ ka rekomanduar më lart rishikimin, unifikimin dhe harmonizimin më të mirë të elementëve të planit mësimor mbështetur në VKM 185 datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 41 datë 24.1.2018.</b></p> <p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit parashikohen procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të elementëve të studimit.</p> <p>Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies edhe në kushtet aktuale të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve online. Studentët sugjerojnë shtimin e orëve të praktikës për një pregatitje më të mirë profesionale.</p> <p><i>(Rregullore e programit të studimit, plani mësimor, takimi me studentët)</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p>Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të UBa për zgjidhje. Dekani i studentëve dhe koordinatori i departamentit janë në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërbejnë si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.</p> <p>Pyetsorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Pyetsorët realizohen çdo vit, 2 herë në vit për secilën lëndë. Nga të dhënat e mbledhura e të përpunuara dalin sugjerimet për përmirësim e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Për tërheqjen periodike të mendimeve dhe sugjerimeve cilësore të studentëve departamentet organizojnë takime periodike me fokus grupe studentësh. <i>(RVB, evidenca 37, takimet në institucion)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Zyra e pranimit</li> <li>– Sekretaria mësimore</li> <li>– Dekani i studentëve</li> <li>– Zyra e Alumni dhe Karrierës</li> <li>– Koordinator i departamentit</li> </ul> Sekretaria mësimore; është e hapur çdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. Dekani i studentëve, Koordinator i departamentit, Zyra e Alumni dhe karrierës ndjekin ecurinë e studentit dhe ofrojnë këshillim për çështjet akademike. <i>(rregulloret, evidencat 9, 12)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor. Studentët inkurajohen për zhvillimin e aftësive të tyre përmes përfshirjes në klube studentore me profile të caktuara. Në takimin me dekanin e studentëve dhe vizitën në ambientet e bibliotekës GVJ u njoh me klubin e medias dhe revistën studentore të UBa. <i>(takimet dhe vizita në institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon zyra e këshillimit të karrierës, Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë</li> <li>– Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune</li> <li>– Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës</li> <li>– Identifikimin e aftësive dhe shprehive</li> </ul> Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj. Zyra ofron një seri aktivitete për orientimin e studentëve në tregun e punës si Open Day, Ditët e informimit, Panairin “Work and Study”. GVJ diskutoi me studentët dhe GVB për mundësitë e punësimit dhe konstatoi se megjithë kërkesën e lartë të vërejtur sidomos gjatë periudhës së pandemisë, në Shqipëri pozicioni i “operatorit dhe këshilluesit në përkujdesje shëndetësore” nuk është



	konfiguruar qartë në tregun e punës. <i>GVJ sugjeroi bashkëpunimin me strukturat e Urdhërit të Infermierit dhe Psikologut për integrimin më të lehtë në tregun aktual të punës.</i> Ndërkohë që studentët u shprehën optimistë për mundësitë e punësimit jashtë vendit. <i>(evidencat 5, 12, takimet në institucion)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Në takimin e GVJ me zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se kjo njësi ka një database me informacion për punësimin dhe vijimin e studimeve (në UBa ose institucione të tjera brenda apo jashtë vendit) të studentëve të diplomuar. Njësia e këshillimit të karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar përmes adresave email apo komunikimeve në rrjetet sociale.  Zyra ka organizuar dhe takimet Alumni ku studentët e diplomuar dhe në karrierë pune ndajnë historitë e tyre të suksesit, shkëmbejnë informacione për tregun e punës dhe krijojnë lidhje me studentët aktualë. <i>(evidenca 12, takimet në institucion)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”, Universiteti “Barleti”**

**Pika të forta dhe afirmimet:**

1. Institucioni disponon kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike te nevojshme në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimor, programin teorik dhe praktikat laboratorike.
2. Kurrikula e programit të studimit me karakter profesional në “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore” është hartuar bazuar në modelet Evropiane, sipas kuadrit ligjorë në fuqi.
3. Marrëveshjet me institucione spitalore dhe komunitare që garantojnë mbështetje logjistike për formimin e plotë profesional të studentëve.

**Pika të dobta:**


1. Njësia përgjegjëse për programin e studimit nuk ka përbushur kërkesat e Ligjit të Arsimit të lartë që lidhen me personelin akademik, sipas të cilit të gjithë Lektorët duhet të jenë të paktën me gradën Doktor i Shkencave. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni konstatohet se pedagogë të kategorisë Master i Shkencave janë lektorë dhe në disa prej lëndëve dhe titullarë lënde, gjithashtu titullarët e lëndëve nuk janë të gjithë të kategorisë profesor.
2. Programi i studimit nuk i përmban të gjitha elementët e organizimit të prashikuar në VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë të ndryshuar”, mungojnë kategoritë A dhe E.
3. Institucioni nuk ka studim të tregut të punës për këtë program studimi.
4. Promovimi jo i mjaftueshëm i programit të studimit me karakter profesional që gjykohet i rëndësishëm për tregun e punës dhe komunitetin.
5. Proçesi i diplomimit nuk përfshihet në detyrimet përmbyllëse të programit mësimor bazuar në VKM 185 datë 25.03.2021.

**Rekomandime:**

1. Riorganizimin e programit mësimor sipas VKM 185 datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar



2. Riorganizimin dhe përditësimin e programit të studimit si ndarjen simestrale të lëndëve të programit, rishikimin e ngarkesës mësimore dhe hartimin e orarit mësimor javor, plotësimi i syllabuseve që mungojnë, plotësimin e marrëveshjeve me institucionet në funksion të programit të studimit.
3. Rishikimin e stafit të angazhuar në mësimdhënie për realizimin e programit mësimor në përputhje me shkallën e tyre të kualifikimit. Titullarët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor.
4. Institucioni duhet të bëjë studime të mirëfillta të tregut të punës, për të promovuar më së miri këtë program studimi.
5. Përditësimin dhe rishikimin e rregullores së departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit dhe rregullores së programit të studimit, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.
6. GVJ rekomandon përditësimin e literaturës në syllabuse.





## **Conclusions of the evaluation of the study program with a professional character in "Operator and Counselor in Health Care"**

### **Strengths and affirmations:**

1. The institution has the necessary infrastructural and logistical capacities in function of the study program for the realization of the teaching process as the theoretical program and the laboratory practices.
2. The curriculum of the study program with a professional character in "Operator and Counselor in Health Care" is designed based on European models, according to the legal framework in force.
3. The institution has partnerships and collaborations with hospital and community institutions that guarantee logistical support for the full professional training of students.


### **Weaknesses:**

1. The unit responsible for the study program does not fully meet the requirements of the Law on Higher Education, according to which all Lecturers must be at least with the degree of "Doctor of Science". In the documentation made available by the institution EEG find that the teacher of the category of Master of Science are lecturers and in some modul/subjects of the program they are course titles, also the course titles are not all of the professor category.
2. The study program does not contain all the elements of organization provided in DCM 41 dated 24.1.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions, changed " Category A and E.
3. The institution does not have a labor market study for this study program.
4. Insufficient promotion of a study program with professional nature that is considered important for the labor market and the community.
5. The graduation process is not included in the concluding obligations of the study program as defined by DCM No.185 dated 25.03.2021.

### **Recomandation:**

EEG recommends as follow:

1. The reorganization of the study program according to DCM No .185 dated 25.03.2021 For some changes and additions to the Decision no. 41 dated 24.1.2018 "On the elements of study programs offered by institutions of higher education", amended.





2. Reorganization and updating of the study program such as define the modules program according to semester, drafting of the weekly teaching schedule, drafting the missing syllabus, review agreements with institutions in function in the study program.
3. Reviewing the staff engaged in teaching process for the implementation of the study program according to their level of qualification. The course holders should be the academic staff of the professor category.
4. The institution should conduct genuine labor market studies to best promote this study program.
5. Updating and Reviewing the Regulation of “ The Department of behavioral sciences and health” and “Regulation of the study program” in order to clearly define the fields of activity.
6. Updating the literature of the syllabus.





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	